

Artistja Anila Rubiku, një nga 100 mendimtarët e botës për 2014-n

"Magazine Foreign Policy" e ka renditur në listën e "100 Leading Global Thinkers of 2014" artisten shqiptare Anila Rubiku. Një qytetare e gjithë botës tashmë, Rubiku merr pjesë në ekspozita kolektive e personale nga Los Angeles në Tel Aviv, me temën e preferuar mbi diktaturën dhe të shkuarën...



Anila Rubiku duke punuar

BLERINA GOCE

“Nuk dua të ndryshoj botën, bëj mirë atë që di”

D Punua e saj i ka rrënjët në problemet sociale dhe është një lloj arti që i bën njerëzit të ndërgjegjësohen për botën rreth tyre, jo vetëm për të tashmen, por edhe për të shkuarën dhe të ardhmen. "Arti nuk mund të ndryshojë gjërat menjëherë, por ai mund të edukojë", shprehet artistja Anila Rubiku, e cila prej vitesh jeton mes Kanadasë, Italisë dhe Shqipërisë. E përzgjedhur si një nga "100 Leading Global Thinkers of 2014" nga "Magazine Foreign Policy", ajo rrefëz në këtë bisedë për "Unë Gruaja", ç'do të thotë ky vlerësim për të, si e percepton ajo ndryshimin përmes artit të saj dhe një prej shfaqjeve të saj të fundit në Muzeun e Tel Avivit (Ekspozita në grup "Under Erasure" në Tel Aviv, Izrael nga 13.12.14 - 18.04.15), ku ajo prezanton një copëz Shqipërie e ku prezantohet dhe artisti tjetër shqiptar, Anri Sala.



"Fearful Intentions", instalacion nga Anila Rubiku



Artistja Anila Rubiku

Jo shumë kohë më parë ju jeni përzgjedhur në listën vjetore të "Magazine Foreign Policy", si një nga njerëzit që po bëjnë ndryshim në botë, të titulluar "100 Leading Global Thinkers of 2014". Ç'do të thotë ky vlerësim për ju?

Revista dhe stafi i "Foreign Policy" më zgjedhën një nga "100 Leading Global Thinkers" për vitin 2014. Që në vitin 1994-95 kur u nisa për të studiuar në Milano e më pas, duke jetuar në shtete e kontinente të ndryshme, më është thënë gjithmonë nga të tjerët, që jam e veçantë ose ndryshe. E veçantë edhe ndryshe ka mijëra kuptime pozitive edhe negative. Në këtë rast pozitiv, sepse këtë radhë për FP të mendoja ndryshe nga të tjerët e të jem e veçantë në fund sjell rezultat pozitiv.

Në ç'mënyrë një grua dhe një artiste mund të ndryshojë botën?

Është e rëndësishme që një individ/person të ndryshojë së pari botën e vet. Të hapë e ndryshojë horizontet e veta edhe më pas, ndoshta, mund të pretendojë edhe të kërkojë të ndryshojë botën. Nuk kam pasur ndonjëherë dëshirën të ndryshoj botën. Kërkoj çdo ditë nga vetja të bëj sa më mirë atë që di të bëj, në fushën e krijimtarisë së artit, të hap horizontet e mia e të jem gjithmonë kurioze ndaj jetës.

Cili është ndryshimi më domethënës që ju keni bërë gjatë jetës suaj dhe me artin tuaj?

Kjo është frazë shumë e madhe. Jam përpjekur e përpjekur të arrij t'i jap mundësinë e fjalës atyre që nuk kanë mundësi të flasin për problemet e tyre. Të bëhem zëri për ata që nuk kanë zë. Projekti më konkret është projekti i grave në burgun 325, "Ali Demi" të Tiranës. Së bashku me psikologun Jeffrey Adams arritëm të flasim e të sjellim jashtë burgut problematikat e grave që ishin e janë në burg. U bëmë zëri për atë grup personash që në Shqipëri nuk kanë zë.

Disa prej projekteve tuaja kanë pasur në qendër figurën e gruas dhe raportin e saj me botën mashkullore. Pse ky ngacim?



"Under Erasure", Muzeu i Tel Avivit

Shumë shpesh në punët e mia ngre problematikat e gjinisë e në veçanti ato të gruas. Arti ka lirinë, mundësinë edhe ndonjëherë detyrën të flasë edhe për problematikat e një shoqërie. Në Shqipëri roli i femrës është mjaft i dobët, në një shoqëri kaq patriakale siç është ajo shqiptare, një grua/femër veten në këtë realitet të ri kur ktheheni herë pas here?

Në një shkrim prezantues për ju thuhet se "Anila Rubiku u rrit në një vend që nuk ekziston më...". Në fakt, sa e gjeni Shqipërinë e viteve të fëmijërisë në Shqipërinë e sotme? Si e gjeni veten në këtë realitet të ri kur ktheheni herë pas here?

Në 2013 më bënë një intervistë për "Los Angeles Times" dhe u përgjigja: "Anila Rubiku u rrit në një vend që nuk ekziston më...". Shqipëria ka ndryshuar shumë. Kemi periudha të ndryshme të Shqipërisë. Shqipëria para viteve 1980, Shqipëria e viteve 1986-1990 dhe Shqipëria e 15 viteve të fundit, ku çdo gjë ndryshon dita-ditë. Teknologjia, arkitektura, planifikimi urbanistik i qendrave të

banuara e gjithçka ndërtohet në emër të modernizimit, që të jemi e të jetojmë me kohët. Gjë kjo shumë e mirë sepse edhe nevojat e shtetasve shqiptarë ndryshojnë çdo ditë. Por shpesh, ky modernizim që bëhet në emër të së resë, varet edhe se si bëhet, ose më mirë kush jep urdhrin ose vendos që të bëhet. Cfarë këndvështrimi e hapësire mendore e perspektivë kanë këta persona/politikanë, që kanë pozicionet për të bërë e marrë vendime. Marr si shembull vetëm bregdetin e Dur-

resit. Kilometra e kilometra pishash të harruara e të zëvendësuar me beton e pallate të pabanuara. Të punuar shumë keq në emër të modernizimit e për të shumë lekë. Ose më mirë në emër të korrupsionit të pangopur të klasës politike, sepse nuk kanë asnjë ide se çfarë është modernizimi i vërtetë. Flitet e dëgjojnë shpesh fjalë të mëdha, si investim me modernizim. Duhet shumë vite të mbjellësh dhe rritësh një pemë. Duhet një sekondë që ta sharrësh. Ndryshimi që shikoj është shpesh i krahasuar me të njëjtin akt të asaj peme - sharrimin.

E lindur në Shqipëri, por mes Torontos, Milanos dhe Tiranës, si e shihni veten mes këtyre lëvizjeve?

Kam lindur e jam rritur në Durrës. Sot jetoj midis Torontos, Milanos, Borum (Turqi) dhe Shqipërisë së Mesme. Jam e kënaqur që kam mundësinë të punoj e të jem shpesh në kontakte me vendë, kultura e gjuhë të ndryshme. Për mua sot është e rëndësishme në procesin tim krijues të jetoj, të udhëtoj e të kem studion

në vende të ndryshme.

Si ndikon tradita dhe ajo çfarë është "shqiptare" në artin tuaj?

Global & lokal sot janë në harmoni njëra me tjetrën, kështu edhe në krijimtarinë e punëve të mia.

Prej disa kohësh jeni artiste në rezidencë në "Hammer Museum" në Los Angeles. Pse keni zgjedhur të "ndriçoni" faqet e errëta të të shkuarës së Shqipërisë? Sa e interesuar është bota për të njohur këtë pjesë tonën? Në ç'mënyrë kjo e shkuar ndikon akoma sot në jetën shqiptare?

Në vitin 2013 isha e ftuar si artiste në rezidencë të "Hammer Museum" në Los Angeles e ku punova mbi dy projekte të reja: "City of lights" dhe "Under Erasure". Në përgjithësi, trajtoj e punoj mbi memorien e mbi të kaluarën në shumë projekte të mia. Në njërin nga këto dy projekte flas edhe mbi të kaluarën në historinë e artit, koleksionizimit dhe atë të Enver Hoxhës. Në njëfarë mënyre, flas edhe për një të kaluar të Shqipërisë. E kaluara e një kombi është gjithmonë shumë e rëndësishme, sado e hidhur apo e ëmël ajo të jetë. Është e rëndësishme, si për vetë popullin, ashtu edhe nga ana historike për të tjerët. Normalisht, e kaluara shkruihet nëpër libra nga fituesit e jo nga ata që humbin. Në rastin e Shqipërisë, fituesit e të humburit për këta 60 vitet e fundit jemi gjithnjë ne, Shqipëria e shqiptarët.

"Under Erasure" është një nga ekspozitat tuaja të fundit të celura në Muzeun e Artit në Tel Aviv. Si paraqiten në këtë ekspozitë dhe çfarë keni parasysh kur flisni për "tërësinë dhe domethënien", fokusuar në prezencën kontradiktore të "të shuarave", të të fshehurave apo atyre që nuk janë më...

Projekti "Under Erasure" u paraqit në Muzeun e Artit Kontemporan në Tel Aviv. Është ekspozitë kolektive mbi fshirjen në fushën e artit. Ky projekt i imi i ri përfshin incisionet, skulptet, prerjet e stampuara në letër, fshirjen me gomë, si edhe një film. Ideja dhe koncepti i këtij projekti është shumë interesant: Sot flitet shumë mbi shijet në ankand të veprave të artit. Flitet shumë mbi spekulimin e parave e sa shumë u shit e sa lekë bëri ose morën për një vepër arti. Asnjë nuk do të dijë se në duart e kujt ka qenë përpara kjo vepër arti? Ka koleksionim të mirë, por ka edhe koleksionim të veprave të artit, që bëhen vetëm për të pasuruar paratë ose u vidhen pronarëve ekzistues, siç ka ndodhur gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një pjesë e madhe e diktatorëve në botë kanë koleksionuar artin për të treguar edhe shijen, diturinë dhe mençurinë e tyre, por në të njëjtën kohë kanë vrarë e prerë dhe futur në burg mijëra njerëz. Ideja ime është: si ka mundësi arti të luftojë sot kundër tyre? Arti i dha shumë gjëra pozitive. A është e mundur arti të luftojë mbrapsht ose më mirë të luftojë diktaturën? A është e mundur të fshihet komplet me gomë e kaluara dhe historia? Historia nuk fshihet me gomë, por është shumë e rëndësishme dhe një akt i vogël kundër diktaturës dhe si gjest-simbol nëpërmjet një veprë arti.